

BAHRI BECI'S COMMITMENT TO THE ALBANIAN LANGUAGE PËRKUSHTIMI I BAHRI BECIT PËR GJUHËN SHQIPE

Jonida CUNGU¹, Alba BALLHYSA²

¹ Department of Linguistics, Faculty of Philology, University of Elbasan „Aleksandër Xhuvani”

² Faculty of Philosophy, University of Koln

*Corresponding author e-mail: jonida_cungu@yahoo.com & albdullaballhysa@gmail.com

Abstract

From the wide range of issues that concern with Albanian language culture, professor Bahri Beci chose to dedicate them with passion and desire to improve the work of the national language. Although in his 80s, his zeal to work for the Albanian language does not stop him, publishing and revealing his skills in the field of publicity through the narration of his life. It is the desire for the words of the Albanian language that drives him to write, not only to argue scientifically and to memorize memories, but to leave behind rich and expensive linguistic assets for linguistic descendants, or for lovers of the language. For his extensive scientific creativity, we would make a comparative approach with the activity of the great researcher, Aleksandër Xhuvani, who initially worked to equip education with language texts accompanied by criteria related to methodology, enabling generations to learn Albanian language with normative goals in school and outside it.

The work started by the colossus of linguistics for a pure and literary language, for the unification of the Albanian language, for its enrichment with new elements from the popular source, for its purification from unnecessary words, etc., was followed with the will and desire of indefatigable by professor Beci, who worked all his life and was in the service of the culture of the Albanian language. A linguist with a wide culture, a good connoisseur of the fields of linguistics, such as: grammar, history of the Albanian language, dialectology, phonetics, pragmatics, literary language and language culture, he will frame his figure as an indomitable worker in an effort to develop, enrich and preserve the identity of the Albanian language, playing the role of a revolutionary from the point of view of perfecting the Albanian language.

Keywords: revolutionization, methodical text, contribution, comparison, grammatical.

Përmbledhje

Nga qerthulli i gjerë i çështjeve që përfshin kultura e gjuhës shqipe, profesor Bahri Beci zgjodhi t'i dedikojë me pasion e dëshirë të mirë punës për zhvillimin dhe ruajtjen e identitetit të gjuhës kombëtare. Edhe pse në të 80-at e tij, zelli për të punuar për gjuhën shqipe nuk resht, duke botuar dhe duke shpalosur aftësitë e tij në fushën e publicistikës nëpërmjet rrëfimit për jetën. Është dëshira për fjalën e gjuhës shqipe që e shtyn të shkruajë, jo vetëm për të argumentuar shkencërisht e për të memorizuar kujtime, por për të lënë pas pasuri gjuhësore të vjera dhe të shtrenjta për pasardhësit gjuhëtarë, apo për dashamirësit e gjuhës. Për krijmtarinë e tij të gjerë shkencore, do të bënim një qasje krahasuese me veprimtarinë e studiuesit të madh, Aleksandër Xhuvani, i cili punoi fillimisht për të pajisur arsimin me tekste gjuhësore të shoqëruara me kriterë të lidhura me metodologjinë, duke i mundur brezave mësimin e gjuhës shqipe me synime normative në shkollë dhe jashtë saj.

Puna e filluar nga kolosë të gjuhësisë për një gjuhë letrare dhe të pastër, për njësimin e gjuhës shqipe, për pasurimin e saj me elemente të rinj nga burimi popullor, për pastrimin e saj nga fjalë të panevojshme etj, u pasua me vullnet dhe dëshirë të paepur nga profesor Beci, i cili punoi gjithë jetën në shërbim të kulturës së gjuhës shqipe. Një gjuhëtar me kulturë të gjerë, një njohës i mirë i fushave të gjuhësisë, si: gramatikë, histori e gjuhës shqipe, dialektologji, fonetikë, pragmatikë, gjuhë letrare dhe kulturë gjuhe, ai do të kornizojë figurën e tij si një punëtor i paepur në përpjekje për zhvillimin, pasurimin dhe ruajtjen e identitetit të gjuhës shqipe, duke luajtur rolin e një revolucionari për nga pikëpamjet në përsosjen e gjuhës shqipe.

Fjalët kyçe: revolucionarizim, tekst metodik, kontribut, krahasim, gramatikë.

Hyrje

Këto rreshta i kushtohen akademikut Bahri Beci, si gjuhëtar i shumëanshëm, i zellshëm dhe reformator në pikëpamjet e tij për fushën e gjuhësisë. I takon bashkësisë së trashëgimisë gjuhësore ndër vite e shekuj për ta dalluar, duke e shquar për intuitën e tij të mprehtë për të rrokur ndryshimin dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës me veprimtarinë e tij shkencore. Veprimtaria e akademikut Bahri Beci shtrihet në një periudhë të gjatë, afro 50-vjeçare, duke zënë një vend qendror në mesin e gjuhëtarëve të shquar. Fillesat e punës kërkimore datojnë në vitet '70, kohë kur punoi për drejtimin e procesit të modernizimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe në shkollat tona.

Duke i kushtuar një përkushtim të veçantë e dashamirësi të kujdesshme trajtimit të gjuhës shqipe, profesor Beci zhvilloi një veprimtari të bollshme studimore në fusha të ndryshme të gjuhësisë, si: gramatikë, histori e gjuhës shqipe, dialektologji, fonetikë, gjuhë letrare dhe kulturë gjuhe. Së fundmi, ai boton dhe librin “Përjetime 1936-2021”, duke shpalosur dhe aftësitë e tij në fushën e publicistikës nëpërmjet rrëfimit për jetën e tij, edhe pse duket se vitet nuk numërohen para krijmtarisë së tij. Në këtë punim ne do të ndalemi në kontributin e prof. Becit në fushën e arsimit. Merita e autorit në fushë të gjuhësisë qëndron në ndjenjën e thellë të mirësisë që ka ai për gjuhën shqipe, jo vetëm për ta përdorur në qasje krahasuese, por edhe për ta shfrytëzuar si burim për mësimin e gjuhës shqipe edhe nga të huajt.

Jetën e tij ia kushtoi gjuhës shqipe dhe më së shumti gjuhës letrare. Ashtu siç vetë thekson autori, se: “çështja e shqipes standarde është me peshë kombëtare, sepse ka të bëjë me prezantimin tonë si popull në botë e përgjithësi, por edhe në Europë në veçanti. Një popull përfaqësohet me gjuhën e tij, ne me gjuhën letrare shqipe”,¹⁶⁶ është një këmbanë, që edhe sot i ndjehet jehona e nevojës për të reflektuar rreth përmirësimit të përdorimit të gjuhës shqipe nga të gjithë. Një prirje e tillë për mbrojtjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe përmes veprave që shquhen për karakterin argumentues shkencor, nëse vazhdohet prej pasardhësve të tjerë gjuhëtarë, do t'i shërbejë ruajtjes së identitetit të gjuhës shqipe, e cila ka nevojë të zhvillohet e pasurohet më tej nga burimi i gjuhës popullore.

Metoda e materiale

Për realizimin e këtij punimi është dashur të përdoren metoda përshkruese, krahasuese dhe analizuese. Si material burimor kanë shërbyer tekstet dhe gramatikat e botuara nga prof. Beci, të cilat janë parë në një qasje krahasuese me kurrikulën, e cila zhvillohet sot në shkollat tona. Të dhënat hulumtuese kanë shërbyer për të krijuar një tablo të qartë për punën shkencore të prof. Becit, e cila është analizuar, për t'u krahasuar më tej në aspektin perceptues dhe angazhues me gjuhëtarin e madh A.Xhuvani.

Diskutime dhe rezultate

Një seri tekstesh të titulluar “Gramatika e gjuhës shqipe”, të dedikuara për mësuesit e gjuhës shqipe dhe “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe”, të punuara për të huajt që duan të mësojnë shqipen, paraqesin në mënyrë të përgjithshme veçoritë strukturore të gjuhës shqipe, duke filluar me objektin e gjuhësisë, fonetikën, strukturën e gjuhës shqipe (sintaksë dhe morfologji), semantikë, si edhe drejtshkrim. Këto tekste në formën e metodave i drejtohen individëve, të cilët duan të përmirësojnë apo të mësojnë gjuhën shqipe.

¹⁶⁶ Intervistë e akademikut Bahri Beci me rastin e promovimit të librit “Përjetime 1936-2021”. <https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>

Një metodologji e munguar, e sjellë në formën më të kuptueshme të mundshme, sjell risi në përpjekjet e kryera nga shumë studiues, të cilët u përpoqën të japin më të mirën për konceptimin e mësimit të gjuhës shqipe. Gramatikat e autorit përfaqësojnë metodat më origjinale dhe bashkëkohore të botuara deri tani, ku shtjellohet me imtësi dhe lehtësisht e kuptueshme struktura gramatikore e gjuhës shqipe. Këto vepra janë përgjithësisht materiale të sintetizuara, me qëllim modernizimin e mësimit të gjuhës amtare. “Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë” mendojmë se konsiderohet vepra më e mirë për mësimin apo përsosjen e gjuhës shqipe, sepse:

- jepen të shtjelluara të gjithë konceptet dhe nocionet bazë të gramatikës së gjuhës shqipe
- materialet janë të përgjithësuara teorikisht, por të shpjeguara dhe të ilustruara me praninë e shembujve të shumtë

- teksti i gramatikës u ofron individëve që do ta përdorin të dhëna në sistem (veçori fonetike, fonologjike, struktura leksikore dhe semantike, morfologjike e sintaksore), të cilat përmirësojnë përdorimin e standardit të gjuhës shqipe

- vepra është një doracak i vyer, e cila u drejtohet dhe u shërben të gjithë individëve sipas niveleve të ndryshme të shkollimit, të cilët kanë qëllim dhe dëshirë të përvetësojnë dhe përmirësojnë aspektin përdorimor të gjuhës shqipe

- i përgjigjet modernizimit të mësimit të gjuhës shqipe, pasi ka tiparet e një teksti shkollor metodik dhe të mirëstudiuar.

Tekstet metodike karakterizohen nga një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme, gjatë leximit të cilëve, çdokush i huaj apo shqiptar do të ndjehej i lehtë në mësimin apo përvetësimin e gjuhës shqipe. Konceptet teorike janë të trajtuara qartësisht dhe të lidhura me shembuj konkret, duke dhënë ndjesinë, se po mëson një gjuhë të ëmbël, të lehtë, por shumë krenare. Tekstet metodike janë botuar me qëllim që t’i dedikohen jo vetëm të huajve që duan të mësojnë gjuhën shqipe, duke e ilustruar teorinë edhe me 15 mësim praktik nga jeta e përditshme, për të zhvilluar aftësi të kënaqshme komunikuese, por edhe të gjithë individëve, të cilët punojnë e përpiqen për të ruajtur dhe kultivuar gjuhën shqipe.

Edhe në tekstet e gramatikave vërehet një kujdes i imët i autorit për të sqaruar çdo aspekt teorik të gjuhës shqipe me një lehtësi interpretuese, sa të kuptuarit e saj është i padiskutueshëm. Në këtë mënyrë struktura e gjuhës shqipe paraqitet e detajuar dhe analitike në të gjitha spektet e veçorive të saj, por është e trajtuar me aq delikatesë shpjeguese, duke e paraqitur gjuhën shqipe të kapshme dhe të pranueshme nga të huajt.

Teksti i gramatikës kushtuar mësuesve të gjuhës shqipe paraqet tërësinë e problemeve gramatikore e fonetike kryesore të shqipes së sotme standarte. I realizuar në një qasje ndryshe, gramatika e këtij lloji është një nga përpjekjet më domethënëse për të realizuar lidhjen e ngushtë midis teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe rolin e gjuhës shqipe në shoqërinë shqiptare. Këto gramatika sollën të re në shkencën e gjuhësisë karakterin metodik të teksteve, të cilat i përgjigjen kërkesave të kohës me arritjet më të fundit në fushë të gjuhësisë. Funkcioni i këtyre teksteve është të jenë në shërbim të praktikës mësimore shkollore, me qëllim zhvillimin e gjuhës letrare, për të cilën akademiku Beci i ka dedikuar gjithë jetën e tij.

Përpjekjet për të punuar në fushë të gjuhësisë së zbatuar tregojnë karakterin e vullnetshëm të akademikut, i cili ka shfrytëzuar çdo shteg në shkencën e gjuhësisë për të lënë gjurmët e tij domethënëse. Për të vlerësuar këto përpjekje madhore në dobi të revolucionarizimit të gjuhës shqipe në shkollat tona dhe më gjerë, do të bënim një analogji me veprimtarinë e studiuesit të madh, Aleksandër Xhuvani, i cili punoi fillimisht për të pajisur arsimin me tekste gjuhësore të shoqëruara me kritere të lidhura me metodologjinë, duke i mundësuar brezave mësimin e gjuhës shqipe me synime normative në shkollë dhe jashtë saj.

Në të njëjtën hulli si A. Xhuvani, i cili paraqiste në veprat e tij një sistem pikëpamjesh, duke pasqyruar qëndrimin dhe kontributin e tij mbi analizën konkrete të problematikave që lidheshin me aspektin përdorimor të gjuhës, edhe prof. B. Beci është përpjekur të mos shkruajë tekste mirëfilli teorike, por gramatika të thjeshta në konceptim, që bëjnë të mundur kuptimin dhe zbatimin më lehtësisht të gjuhës shqipe. E përbashkëta e Xhuvanit dhe Becit qëndron në përpjekjen e tyre për hartimin e teksteve të gramatikave të mbështetura në të dhëna sistematike, me qëllim ngulitjen e normë gjuhësore të përdoruesit e gjuhës shqipe dhe ata që kanë dëshirë ta mësojnë atë. Tekstet kanë qenë një ndihmë e madhe për praktien mësimore të shkollës, nisur nga fakti që i përgjigjeshin natyrës së një teksti shkollor.¹⁶⁷

Gjithashtu, e përbashkëta e gramatikave të Xhuvanit dhe Becit qëndron në përpjekjen e tyre për të sjellë diçka ndryshe në fushën e gramatologjisë shqiptare, ku për herë të parë kemi tekste që janë të organizuara në bazë të karakterit metodik të tyre.¹⁶⁸ Përfshirja e ushtrimeve të shumta, gjuha e thjeshtë dhe lënda e pasur metodike, na shtyn t'i vlerësojmë këto vepra si kontribute të njëpasnjëshme të dy studiuesve të ndryshëm, të cilët kishin si qëllim lëvrimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe për të gjithë kategoritë e njerzve.

Puna e filluar nga kolosë të gjuhësisë për një gjuhë letrare dhe të pastër, për njësimin e gjuhës shqipe, për pasurimin e saj me elemente të rinj nga burimi popullor, për pastrimin e saj nga fjalë të panevojshme, u pasua me vullnet dhe dëshirë të paepur nga profesor Beci, i cili punoi gjithë jetën në shërbim të kulturës së gjuhës shqipe. Edhe tekstet “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për anglezët); “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për francezët); “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për italianët); “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për gjermanët); “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për spanjollët); “Të mësojmë shpejt gjuhën shqipe” (për rusët), apo grammatikat e botuara prej tij, janë një përpjekje madhore për të çuar më tej punën e trashëguar nga studiues si: Kristoforidhi, Xhuvani apo edhe më herët me rilindasit.

Tek autori ka spikatur gjithnjë dëshira e tij dhe qëllimi punëmirë për të ngritur gjuhën shqipe, e sidomos gjuhën popullore në një stad revolucionarizmi, duke u identifikuar si reformator për çështjen e gjuhës shqipe nëpër shkolla. Ai është i vetëdijshëm se burimi për një përvetësim të mirë të gjuhës shqipe, përsosja e saj në një nivel më të përparuar e të zhvilluar, gjendet në shkollë tek arsimtarët e këtij vendi dhe të nxënësit, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës letrare. Për këtë arsye, autori punoi me një vullnet skrupuloz, për të sjellë në duart e përdoruesve dhe dashamirësve të gjuhës tekste të gramatikës dhe tekste metodike për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim që të plotësonin një boshllëk të konsiderueshëm në fushën e gjuhësisë, siç është dhe aspekti përdorimor i gjuhës.

Të mësuarit e gjuhës shqipe në shkollat tona është perceptuar nga prof. Beci si një përgjegjësi që duhet të fillojë nga mësuesit e shkollave, të cilët përcjellin te brezat përvetësimin e gjuhës shqipe. Ndaj ai i kushton një rëndësi të veçantë përgatitjes së përgatitorëve, të cilët kanë komunikim të drejtpërdrejtë me nxënësit. Profesionalizmi i mësuesve do të shërbejë për lëvrimin më të saktë të gjuhës shqipe te brezat e rinj.

Tekstet metodike gramatikore mbartin rëndësinë dhe vlerën e veçantë, sepse zhvillimi i gjuhës shqipe në strukturën e programit dhe në metodën e mësimdhënies është një revolucion, që i njihet mësimi të gjuhës shqipe në shkolla (sipas vetë autorit). Mendimi i tij për mësimin e gjuhës shqipe (qoftë nga folësit e saj, qoftë nga të huajt) me anë të zbatimit të gërshtimit të gjuhës dhe ligjëritimit konkret në një të vetëm, i qaset edhe sot reformës kurrikulare, ku rubrikat (të folurit, të dëgjimit, të shkruarit, të leximit) për të mësuar gjuhën shqipe janë vazhdim i kësaj përvoje të përmendur vite e vite më parë.

¹⁶⁷ Kastrati, J. (1980). Kontributi i Aleksandër Xhuvanit në gramatologjinë shqiptare”, në “Studime filologjike”, 1.

¹⁶⁸ Po aty, fq.100.

Madje, edhe ndërtimi i teksteve shkollore sot për lëndën e gjuhës shqipe, ku i lihet një hapësirë e konsiderueshme nxënësit, që të hulumtojë mbi materialin mësimor, i shkon për shtat idesë së profesor Becit, i cili ngulmonte në risinë që duhej të përçohet për mësimin e gjuhës shqipe. Në këtë këndvështrim, gramatikat e B.Becit janë një udhërrëfyes me vlerë për procesin e mësimdhënies nga ana e mësuesve në shkollat tona, që shërbejnë për plotësimin e boshllëqeve të krijuara nga ndryshimet e herëpashershme në tekste e kurrikula.

Është e udhës që perceptimet metodike të prof.Becit në fushë të përdorimit të gjuhës shqipe, duhet të merren në konsideratë nga hartuesit e teksteve shkollore sot, të cilët duhet t'i qasen natyrës praktike dhe metodike të gramatikave të tij. Natyra metodike e gramatikave u përgjigjet kërësive të teksteve shkollore. Aspekti konkret dhe praktik i teksteve shkollore duhet të fokusohet te gërshetimi midis gjuhës dhe ligjërimit konkret të nxënësit, me qëllim që përdorimi i gjuhës shqipe në mënyrë të drejtë të jetë më efikas për nxënësit.

Përfundime

Akademiku Bahri Beci nuk ishte vetëm studiues i gjuhës shqipe. Ai shkruajti dhe në fushën e publicistikës, duke krijuar një dimension të ri për veten: individin e interesuar për çështje edhe më të përgjithshme, intelektualin e urtë që lë gjurmë në çdo rresht që shkruan. Këto mendime përforcohen më tepër gjatë leximit të veprave “Një libër që nuk do të doja ta shkruaja” dhe “Përjetime 1936-2021”, ku shpaloset përmasa e tij njerëzore, me sakrificat, sfidat, kritikën, pse jo dhe brengat e tij.

Gramatikat e botuara nga prof. Beci janë kryesisht tekste metodike, të cilat shënojnë modernizimin e mësimin të gjuhës shqipe. Ato paraqesin rezultatet e arritura në fushë të gramatologjisë për mësimin e gjuhës shqipe, e cila i dedikohet nxënësve, mësuesve dhe dashamirësve që duan të mësojnë ose të përsosin më tej përdorimin e gjuhës amtare. Këto tekste shënojnë revolucionarizimin e gjuhës shqipe në një metodë mësimdhënëse, ku gërshetohet gjuha dhe ligjërimi konkret në një të vetëm, me qëllim zhvillimin e gjuhës shqipe në çdo kohë.

Në një qasje krahasuese, gramatikat e prof.Becit janë vlerësuar si metoda të sintetizuara mësimore, që vijnë në të njëjtën vijë konceptimi si tekstet gramatikore të A.Xhuvanit, të cilat udhëhiqeshin nga karakteri metodik dhe janë të vlefshme për përdorimin e tyre si tekste shkollore nga nxënës, mësues dhe individë që synojnë të përmirësojnë përdorimin e gjuhës shqipe. Duke rrokur veprimtarinë e gjerë dhe kontributin e vyer të profesor Bahri Beci në pjesën më të madhe të fushave të gjuhësisë, mund të themi se ai ka spikatur për një përgatitje të lartë shkencore e gërshetuar me dashurinë për përsosjen e gjuhës shqipe, duke ndihmuar në zhvillimin e mendimit shkencor shqiptar në fushë të gjuhësisë.

Referencat

- [1]. Beci, B. “Gramatika e gjuhës shqipe”, Tiranë 1997.
- [2]. Beci, B. “Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë”, Tiranë 2004.
- [3]. Beci, B. “Gramatika e gjuhës shqipe”, Tiranë 2010.
- [4]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për anglezët), Tiranë 2011.
- [5]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për francezët), Tiranë 2007.
- [6]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për italianët), Tiranë 2006.
- [7]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për gjermanët), Tiranë 2011.
- [8]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për spanjollët), Tiranë 2011.
- [9]. Beci, B. “Të mësojmë shpëjt gjuhën shqipe” (për rusët), Tiranë 2012.
- [10]. Beci, B “ Problemet e mësimin të gjuhës amtare në shkollë...”.
- [11]. <http://s2.e-monsite.com> > 2009/12/10 > 97618954...
- [12]. Domi, M. “Aleksandër Xhuvani lëvruet dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe”, në “*Studime filologjike*” 1, Tiranë 1980.

- [13]. Intervistë e akademikut Bahri Beci me rastin e promovimit të librit “Përjetime 1936-2021”.
<https://liberale.al/perjetimet-e-nje-akademiku-si-bahri-beci/>
- [14]. Kastrati, J. (1980). Kontributi i Aleksandër Xhuvanit në gramatologjinë shqiptare”, në “*Studime filologjike*”, 1.
- [15]. “Studime filologjike” 1, Tiranë 1980.
- [16]. Xhuvani, A. (1919). “Libri i gjuhës a gramatikë” (Pjesa e parë, për rendin e tretë të shkollës fillore. Elbasan.
- [17]. Xhuvani, A. (1934). “Sintaksa shqip, pjesë e dytë, për klasat e ulta të shkollave të mesme, Tiranë.